

STRUKTURAT AKOMODUESE

Qershor 2026

Në Qershor 2026, numri i vizitorëve që u akomoduan në strukturat turistike në Shqipëri u rrit me 17,0 %, krahasuar me të njëjtin muaj të vitit të kaluar.

Vizitorët rezidentë u rritën me 7,0 %, ndërsa vizitorët jo-rezidentë me 20,6 %.

Net-qëndrimet

- Net-qëndrimet gjithsej u rritën me 9,8 %;
- Net-qëndrimet e vizitorëve rezidentë u rritën me 11,8 %;
- Net-qëndrimet e vizitorëve jo-rezidentë u rritën me 9,2 %.

Vizitorët e huaj sipas vendeve

Shumica e vizitorëve të huaj që u akomoduan në Shqipëri vijnë nga:

- Kosova (15 %)
- Italia (14 %)
- Polonia (13 %)
- Vizitorë nga Franca dhe Gjermania përbëjnë përkatësisht me nga 7 %
- Nga vende të tjera (44 %).

Shfrytëzimi i hoteleve

Norma e shfrytëzimit të dhomave në hotele arriti 41,3 %, nga 39,5 % në Qershor 2025, duke shënuar një rritje me 1,8 pikë përqindje.

FIG. 1 VIZITORË DHE NET-QËNDRIME GJITHSEJ (000)





FIG.2 VIZITORË JO-REZIDENTË SIPAS SHTETEVE



TAB. 1 VIZITORË SIPAS RAJONIT, AFËRSISË ME BREGDETIN DHE LLOJIT TË STRUKTURAVE AKOMODUESE

	Rezidentë		Jo-rezidentë	
	Qershor 2025	Qershor 2026	Qershor 2025	Qershor 2026
Rajonet				
Rajoni i Veriut	34.611	38.082	97.302	123.261
Rajoni Qendër	40.401	37.976	154.170	181.180
Rajoni i Jugut	56.481	64.704	118.211	141.405
Zonat e afërsisë me bregdetin				
Zona Bregdetare	86.885	98.767	253.867	323.426
Zona Jo-bregdetare	44.608	41.995	115.816	122.420
Përshkrimi i llojit të strukturës akomoduese				
Hotele dhe akomodime të ngjashme	122.295	126.927	336.226	401.836
Akomodime për pushime dhe të tjera akomodime afatshkurtra	8.873	13.078	27.227	39.457
Hapësirat për kampingje, për parqe, për çadra ose rulota argëtimi	325	757	6.230	4.553
Gjithsej	131.493	140.762	369.683	445.846

Shënim për përdoruesit:

- Të dhënat e detajuara janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT: [Strukturat Akomoduese](#)
- Në zbatim të Politikës së Trajtimin të Gabimeve, INSTAT ndërmerr pa vonesë korrigjimin e çdo gabimi të identifikuar në statistikat zyrtare të publikuara. Përdoruesit informohen në mënyrë të menjëhershme dhe transparente për korrigjimet dhe ndryshimet e reflektuara, në përputhje me parimet e paanshmërisë, transparencës dhe cilësisë së statistikave zyrtare. Politika e plotë e Trajtimin të Gabimeve është e disponueshme në adresën: <https://www.instat.gov.al/media/9577/politika-e-trajtimin-te-gabimeve.pdf>

Metodologjia

Informacion mbi vrojtimin

INSTAT llogarit dhe publikon treguesit mujor të statistikave të akomodimit që përbëjnë ofertën turistike në vend, duke përdorur metodën e vrojtimin tërësor të mbledhjes së të dhënave pranë strukturave akomoduese. Metodologjia synon grumbullimin, prodhimin dhe publikimin e të dhënave cilësore në përputhje me Rregulloren e Bashkimit Europian (EU) nr. 692/2011 të statistikave Europiane të turizmit dhe amendimeve të saj.

Qëllimi i vrojtimit mbi strukturat akomoduese është të monitorojë aktivitetet turistike, të llogarisë treguesit statistikor mbi ofertën akomoduese të turizmit shqiptar, që janë të rëndësishëm për të përcaktuar tendencën e zhvillimit të kapaciteve të sektorit të turizmit. Të dhënat mbledhen çdo muaj nëpërmjet pyetsorit “Anketa e Strukturave Akomoduese”.

Fusha e mbulimit

Në anketën e strukturave akomoduese përfshihen të gjitha njësitë statistikore nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve të vitit 2025 dhe nga ai i Njësive Lokale, që kanë si aktivitet të tyre ekonomik parësor ose dytësor akomodimin turistik, gjatë periudhës referencë.

Strukturat akomoduese turistike klasifikohen dhe përshkruhen në grupe sipas klasifikimit NVE Rev. 2 si vijon:

55.10 Hotele dhe akomodime të ngjashme. Kjo klasë përfshin: hotele, resort hotelier (kompleks turistik), hotel suita / apartamente, motele.

55.20 Akomodime për pushime dhe të tjera akomodime afatshkurtra. Kjo klasë përfshin: shtëpi pushimi për fëmijë dhe të tjerë, apartamente dhe shtëpi njëkatëshe për vizitorë, shtëpi pushimi familjare pa shërbim në dhomë, bujtina të rinjsh dhe streha malore.

55.30 Hapësirat për kampingje dhe për parqe, për çadra ose rulota argëtimi. Kjo klasë përfshin kampingje e parqe për çadra, automjete ose rulota për vizitorët me qëndrim të shkurtër.

Strukturat akomoduese dhe vizitorët e pa regjistruar nuk janë subjekt i këtij studimi.

Treguesit që mbledhen nga anketa përfshijnë:

- Numri i vizitorëve rezidentë;
- Numri i vizitorëve jo – rezidentë;
- Net-qëndrimet nga vizitorët rezidentë;
- Net-qëndrimet nga vizitorët jo – rezidentë;
- Dhomat/kampet e zëna nga vizitorët rezidentë;

- Dhomat/kampet e zëna nga vizitorët jo - rezidentë;
- Numri i dhomave/kampeveë;
- Numri i shtretërveë;
- Numri i strukturave akomoduese që disponon një ose më shumë dhoma për personat me lëvizshmëri të reduktuar;

Mbledhja e këtyre treguesve dhe llogaritja e niveleve të kapacitetit dhe shfrytëzimit realizohen bazuar në Aneksin I "Oferta turistike-Statistikat e Akomodimit" të Rregullores së Bashkimit Europian (EU) nr. 692/2011.

Përkufizime

Struktura akomoduese përfshin të gjitha njësitë e akomodimit turistik që ofrojnë, si një shërbim të paguar (çmimi mund të subvencionohet pjesërisht ose plotësisht), shërbime akomodimi afatshkurtër ose qëndrimi të shkurtër.

Dhomë: njësia e përbërë nga një dhomë ose grupe dhomash të cilat janë të marra me qira nga vizitorët (turistët) si një e tërë (qira e pandashme).

Dhomë për personat me lëvizshmëri të reduktuar PRMs (përfshirë dhe personat në karrige me rrota): dhoma duhet të jetë e aksesueshme për personat me lëvizshmëri të reduktuar dhe t'i ofrojë atyre mundësitë e përdorimit të të gjitha faciliteteve të dhomës ashtu si për vizitorët e tjerë pa kufizime fizike.

Shtrat: përcaktohet nga numri i personave që mund të qëndrojnë gjatë natës në një shtrat, duke përjashtuar shtretërit ekstra të vendosur sipas kërkesës së vizitorit.

Vizitorë: është një person i cili qëndron të paktën një natë në hotel duke përfshirë edhe fëmijët.

Rezident: konsiderohet ai person që ka banuar në Shqipëri për më shumë se 12 muaj radhazi.

Jo-Rezident: konsiderohet ai person që nuk ka banuar në Shqipëri për më shumë se 12 muaj radhazi.

Net-qëndrimi: është çdo natë që një vizitor / turist (rezident ose jo-rezident) aktualisht shpenzon (fle apo qëndron) në një njësi akomodimi.

Norma neto e shfrytëzimit të shtretërve = $\frac{\text{Numri i net qëndrimeve}}{\text{Numri i shtretërve të disponueshëm}} * 100$ që mat përqindjen e shfrytëzimit të shtretërve në "Hotele dhe akomodime të ngjashme".

Norma neto e shfrytëzimit të dhomave = $\frac{\text{Numri i dhomave të zëna}}{\text{Numri i dhomave të disponueshme}} * 100$ që tregon përqindjen e shfrytëzimit të dhomave në "Hotele dhe akomodime të ngjashme".

Rajonet statistikore në nivelin 1, 2 dhe 3 përcaktohen sipas ndarjes territoriale NUTS II, i cili është një klasifikim i unifikuar dhe përdoret si bazë për mbledhjen dhe përpunimin e Statistikave Rajonale Evropiane. Informacioni më poshtë përfshin se cilat prefektura janë në rajonin e Veriut, Qendrës dhe Jugut.

Rajoni i Veriut: Dibër; Durrës; Kukës; Lezhë; Shkodër

Rajoni Qendër: Elbasan; Tiranë

Rajoni i Jugut: Berat; Fier; Gjirokastrë; Korçë; Vlorë

Zonat bregdetare janë Njësi Administrative Vendore (LAU) që janë në kufi ose afër një vijë bregdetare. Zonat bregdetare klasifikohen sipas dy kategorive të mëposhtme:

- **Zonat bregdetare:** LAU që kufizohen me vijën bregdetare ose LAU që kanë të paktën 50% të sipërfaqes së tyre në një distancë prej 10 km nga vija bregdetare;
- **Zonat jo-bregdetare:** LAU që nuk janë "zona bregdetare"; që nënkupton LAU që nuk kufizohen me vijën bregdetare dhe kanë më pak se 50% të sipërfaqes së tyre në një distancë prej 10 km nga vija bregdetare.